



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1442 Prot.

Tiranë, më 16.07.2026

VENDIM QARKULLUES

Nr. 109, datë 16.07.2026

**“PËR
MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT NË PROGRAMIN E CIKLIT TË DYTË
MASTER I SHKENCAVE NË “FIZIOTERAPI KLINIKE DHE REHABILITIM”
PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027 NË UST”**

Në zbatim të nenit 3, pikës 7 të nenit 25, nenit 38, pikës 3 të nenit 69, të Ligjit Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL-të e Republikës së Shqipërisë”, të VKM nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, të nenit 7, nenit 20 dhe nenit 72 të Statutit të UST, të nenit 7 të Rregullores së UST; bazuar në propozimin e Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit nr.2308/21 Prot., datë 07.07.2026 “Propozim për miratim të kuotave për programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Fizioterapi klinike dhe rehabilitim” për vitin akademik 2026-2027”, Senati

VENDOSI:

1. Të miratojë kuotat e pranimit të studentëve në programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Fizioterapi klinike dhe rehabilitim” për vitin akademik 2026-2027, sipas tabelës bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Ky Vendim i përcillet për miratim Bordit të Administrimit.
3. Ky Vendim i përcillet për njohje dhe zbatim e publikim Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore.
4. Një kopje e këtij Vendimi i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

KRYETARI I SENATIT

Prof.Dr. AGRON KASA

